c) Rezervimi i vendparkimit për automjete të personave fizikë/juridikë..................25 €/muaji
d) Rezervimi i vendparkimit për xhipa..........................................35 €/muaji

5.4 Nga pagesa e parkimit të automjeteve mund të lirohen kategori e caktuar e personave, me Vendim të drejtorit të organit kompetent për punët e shërbimeve publike.
5.5 Të gjitha ngarkesat do të paguhen përmes një autoriteti bankar të licencuar dhe do të trajtohen si të hyra vetanake të Komunës.
5.6 Pa dëshminë mbi pagimin e taksës nuk mund të merret automjeti.

6. Ngarkesat për dhënien në përdorim të pronës komunale

a) Qiraja për dhënien e tokës në shfrytëzim për ndërtimin e ndërtesave individuale, tarifa mujore..........................................................................................0,30 €/m²;
b) Qiraja për dhënien në shfrytëzim të objektit për banim - pronë komunale, tarifa mujore..........................................................................................0.30 €/m²;



Adresa: Rr. UÇK- 2-10 000 Prishtinë-Kosovë
Telefoni: 381(0)38 230-900
http://www.prishtina-komuna.org

c) Renta për tokën e dhënë në shfrytëzim të përkohshëm:

- 0 deri 100 $m^2$ ............................................................................................4 €/$m^2$ në vit;
- 101 deri 500 $m^2$.......................................................................................3,5 € /$m^2$ në vit;
- 501 - 1000 $m^2$ ......................................................................................3,00 € /$m^2$ në vit;
- -1001-10000 $m^2$ ....................................................................................1,5 € /$m^2$ në vit;
- mbi 10000 $m^2$......................................................................................0.60 €/ $m^2$ në vit.

6.1

a) Për shfrytëzimin dhe përdorimin e tubacionit në infrastrukturën nëntokësore nga personi i tretë në projektet e investuara nga Komuna paguhet taksa vjetore në lartësi prej ...........................................................................8 € në m gjatësi

b) Për investimet vetanake të personit të tretë në infrastrukturën nëntokësore hapja e kanaleve, vendosja e tubave dhe punimeve në puseta, paguhet taksa në metër gjatësi të projektit realizues në lartësi prej ...............................................3 €.

Nëse përdorues apo investues në projektet nga pika a dhe b e kësaj tarife është ndërmarrja publike lokale, nuk do të llogaritet kjo taksë.

6.2 Ndërtimi i antenave, TV, PTK, kabllove dhe të ngjashme, paguhet:

Tarifa sipas vlerave:

Tarifa I ..........................................................................................4‰ (promil) 50000 €
Tarifa II ...........................................................................3,5 ‰ (promil) 50.000 - 100000 €
Tarifa III ...........................................................................3 ‰ (promil) 100.000 - 500000 €
Tarifa IV ..........................................................................................2 ‰ (promil) 500000 €

6.3 Shtrirja e rrjetit kabllor të internetit ..............................................................1 € m gjatësi.

6.4 Vendosja e qoshqeve (kiosqeve) dhe objekteve tjera montuese, në të cilat kryhet kryesisht veprimtaria tregtare, tarifat mujore sipas zonave janë:

Zona :
I ........................................................................................................10 € $m^2$,
II........................................................................................................8 € $m^2$,
III.......................................................................................................6 € $m^2$,
IV.......................................................................................................4 € $m^2$,

6.5 Vendosja e pajisjeve për akullore dhe të ngjashme, tarifat mujore sipas zonave janë:

Zona :
I.......................................................................................................15 €/aparat,
II......................................................................................................10 €/aparat,
III.......................................................................................................7 €/aparat,
IV.......................................................................................................5 €/aparat,

6.6 Vendosja e stendave të hapura dhe lëvizëse për shitjen e librave jo shkollor, tarifat mujore sipas zonave:



Adresa: Rr. UÇK- 2-10 000 Prishtinë-Kosovë
Telefon: +381(0)38 230-900
http://www.prishtina-komuna.org

Zona :
I.......................................................................................30 €,
II......................................................................................25 €,
III.....................................................................................20 €,
IV......................................................................................10 €.

Kuvendi i bartë të drejtën Kryetarit që të bëjë lirimin nga pagimi i kësaj tarife në raste të caktuara.

6.7 Vendosja e foltoreve telefonike:

Tarifa mujore për foltore ..................................................................200 €.

6.8 Për vendosjen e shkallëve para objektit, në të cilin ushtrohet veprimtaria e regjistruar, 100 €/m² në vit.

6.9 Shfrytëzimi i hapësirës para objektit, në të cilin kryhen shërbimet tregtare dhe hoteliere, tarifat mujore sipas zonave janë:

Zona :
I .......................................................................................8 €/m²,
II......................................................................................6 €/m²,
III.....................................................................................4 €/m²,
IV......................................................................................3 €/m².

6.10 Shfrytëzimi i hapësirës publike për vendosjen e automjetit lëvizës për shitjen e ushqimit të shpejtë, tarifa mujore ..................................................................50 €

6.11 Shfrytëzimi i hapësirës publike për vendosjen e tendave (çadrave) të hapura lëvizëse me mekanizëm, tarifa vjetore për tendë ..................................................8 €/m²

6.12 Shfrytëzimi i hapësirës publike për vendosjen e lojërave të fëmijëve, tarifa vjetore .....3 €/m²

6.13 Shfrytëzimi i hapësirës publike për vendosjen e gjeneratorëve statikë, tarifa mujore sipas zonave:

Zona I ..................................................................................10 €/m²
Zona II ..................................................................................8 €/m²
Zona III .................................................................................6 €/m²

6.14 Për shfrytëzime të tjera të hapësirës publike – ekspozimi dhe deponimi i mallit, ambalazhi, tarifa mujore sipas zonave është:

Zona:
I .......................................................................................20 €/m²,
II......................................................................................15 €/m²,
III.....................................................................................10 €/m²,
IV......................................................................................5 €/m²,



Adresa: Rr. UÇK, K- 2-10 000 Prishtinë-Kosovë
Telefon: +381(0)38/230-900
http://www.prishtina-komuna.org

6.15 Ekspozimi i panove reklamuese dhe muraleve në qytet, tarifa vjetore....................50 €/m²,

6.16 Ekspozimi i panove reklamuese dhe muraleve me ndriçim në qytet, tarifa vjetore .........................................................................................................................................65 €/m²,

6.17 Ekspozimi i automjetit vetëm për qëllime reklamuese, tarifa vjetore .........................................................................................................................................100 €/m²,

6.18 Ekspozimi i panove reklamuese jashtë qytetit, tarifa vjetore..........................................30 €/m²,

6.19 Ekspozimi i panove reklamuese me ndriçim, jashtë qytetit, tarifa vjetore ..............45 €/m²,

6.20 Ekspozimi i reklamave në automjete, autobus, tarifa vjetore, ..................................20 €/m²,

6.21 Ekspozimi i reklamave në automjete, automjete 8 +1 ulëse, tarifa vjetore...............20 €/m²,

6.22 Ekspozimi i reklamave në automjete 4 + 1 ulëse, tarifa vjetore..................................20 €/m².

6.23 Vendosja e ekraneve elektronike reklamuese, tarifa vjetore .......................................70 €/m²

6.24 Ngarkesat për pagimin e tarifave paguhen me rastin e marrjes së lejes për vendosjen e panove reklamuese.

6.25 Ndalohet reklamimi i pijeve alkoolike dhe duhanit përmes panove reklamuese.

**7. Tarifat për shërbimet komunale**

**7.1 Tarifat për inspektim**

Inspektimi veterinar për kafshë (lopë, kuaj), tarifa.......................................................................5 €,
Inspektimi veterinar për kafshët e imëta (dele, dhi, qen, mace), tarifa.........................................1 €,
Vërtetim i lëshuar për kafshët e imëta nga ndërmarrja e licencuar, tarifa ..................................1 €,

7.2 Kryerja e shërbimeve profesionale, siç janë studimi i tokës dhe kadastrës, shënimi i sipërfaqeve dhe parcelave, vëzhgimi i tokës dhe i pronës dhe aktiviteteve të ngjashme nga organi përkatës për punët e kadastrës bëhet sipas Udhëzimit administrativ, të caktuar nga Ministria përkatëse për Administratë.

**8. Tarifat për ndërtim dhe demolim të ndërtesave.**
8.1 Kompensimi për rregullimin e tokës ndërtimore llogaritet në bazë të projektit kryesor të objektit investiv, sipas të cilit është lëshuar leja ndërtimore. Llogaritja e këtij kompensimi bëhet në bruto sipërfaqe m² të objektit investiv, pa termoizolim të jashtëm dhe fasadë, sipas vendimit të veçantë të lëshuar nga organi kompetent për urbanizëm dhe ndërtim.

a) Lartësia e kompensimit për rregullimin e tokës ndërtimore do te jetë:
- për ndërtimin e objektit investiv, të destinuar për ndërtim individual (deri në 450 m² ...........................................................................................................12 € m²;



Adresa: Rr. UÇK- 2-10 000 Prishtina-Kosovë
Telefon: +381(0)38 230-900
http://www.prishtina-komuna.org

- për ndërtimin e objektit investiv individual, të destinuar për shitje ..........................18 € m²;
- për ndërtimin e objektit investiv, të tërësisë së përbashkët (kolektiv) ..........................30 € m²;
- për ndërtimin e objektit investiv me destinim për afarizëm .......................................... 50 € m²;
- për ndërtimin e objektit me destinim për arsim, shëndetësi, sport, kulturë dhe të ngjashme, me qëllim përfitimi............................................................................................ 20 € m²;
- për ndërtimin e objektit industrial, prodhues e të ngjashëm ..........................................6 € m²;
- për depo e mbyllur................................................................................................................20 € m²;
- për depo gjysmë e hapur .......................................................................................................6 € m²;
- për ndërrimin e destinimit të përdorimit të hapësirave nga ai ekzistues, në destinim për afarizëm ..........................................................................................................50 € m²;
- për ndërrimin e destinimit të përdorimit të hapësirave nga ai ekzistues, në destinim për banim.... ..............................................................................................................1 € m²;
- për objektet e destinuara për banim individual, të cilat tejkalojnë sipërfaqen 450 m² (objekte rezidenciale), kompensimi për rregullimin e tokës ndërtimore në sipërfaqen e tejkaluar, do të llogaritet në lartësinë prej ......................................................................15 € në m²;
- për ndërtimin dhe vendosjen e objekteve nëntokësore - rezervuar të karburanteve dhe të ngjashme, kompensimi për rregullimin e tokës ndërtimore do të paguhet në lartësinë prej ....................................................................................... 0,25 € të kapacitetit – vëllimit në litër.

b) Lartësia e taksës administrative:

- për paraqitjen e kërkesës për lëshimin e lejes urbanistike...............................................10 €;
- për paraqitjen e kërkesës për lëshimin e lejes ndërtimore ...............................................10 €;
- për paraqitjen e kërkesës për lejen e përdorimit..............................................................10 €.

c) Lartësia e tarifës do të zvogëlohet:

- 50 % për ndërtimin e objektit në themele të vjetra;
- 50 % për fshatrat, kufijtë kadastral të të cilave janë të kufizuara me rrugët parësore;
- 80 % për fshatrat tjera të territorit të komunës;
- 50 % për ndërtimin e objekteve investive ekzistuese që posedojnë leje ndërtimi dhe dokumentacionin tjetër teknik;
- 70 % për sipërfaqen bruto të bodrumit dhe garazhit në kuadër të objektit;
- 25 % për sipërfaqet e tarracave të pambuluara;
- 50 % për ndërtimin e garazheve dhe objekteve ndihmëse jashtë objektit individual të banimit;
- 50 % për hapësirat publike që përbëjnë lidhjen e dy objekteve ndërtimore me destinimin përkatës - pasazhet.

d) Për ndërrimin e destinimit për përdorimin e hapësirave nga ai ekzistues për destinim për afarizëm/banim, lartësia e taksës e përshkruar në shkronjën a) do të paguhet vetëm ndryshimi i taksës nga ai i paguari në bazë të lejes për ndërtim dhe lartësisë së taksës së përshkruar sipas kësaj pike.
Për hapësirat e përbashkëta në kuadër të objektit të tërësisë së përbashkët, të cilat i shërbejnë objektit si tërësi apo një pjese të saj, lartësia e kompensimit do të paguhet 50%, nga shuma prej 30 €.

e) Investuesi nuk është i obliguar të bëjë kompensimin për rregullimin e tokës ndërtimore, nëse:

- ndërton objekt të karakterit social, shëndetësor, arsimor ose fetar (joprofitabil),
- ndërton objekt banimi për zgjidhjen e çështjes së banimit të familjes së ngushtë të dëshmorit ose të invalidit të luftës,



Adresa: Rr. UÇK- 2-10 000 Prishtinë-Kosovë
Telefon: +381(0)38 230-900
http://www.prishtina-komuna.org

- ndërton objekt të pronësisë shtetërore për nevojat e interesit të përgjithshëm,
- është shoqatë humanitare dhe ndërton objekt për destinim humanitar,
- rindërton objektin banesor të dëmtuar nga lufta apo fatkeqësitë tjera elementare sipas kategorisë IV dhe V të shkallës së dëmtimit,
- ndërton objektin investiv në pronësi komunale me mjete financiare si donacione nga organizatat – shoqatat humanitare,
- ndërton objekt investiv në fshatrat që kufizohen me zona kufitare, destinimi i të cilave është banimi individual dhe objektet që kanë për qëllim zhvillimin e bujqësisë.

f) Objektet e destinuara për lëmenjtë: arsimor, kulturor, sportiv, shëndetësor, si dhe qendrat rekreative që ndërtohen me mjete buxhetore me investim të komunitetit apo me donacione, dhe janë të interesit të përgjithshëm, janë të liruara nga pagesa për shkak të destinimit të tyre.

Në rastet kur kemi të bëjmë me ndërtim nga ana e personave që nuk janë cekur më lart, si p.sh. qendër rekreative apo ent shëndetësor, atëherë duhet të merret leje e veçantë nga Këshilli i Drejtorëve për lirim nga pagesa.

g) Llogaritja e lartësisë së pagesës së taksës për rregullimin e tokës ndërtimore bëhet nga Drejtoria përkatëse e Urbanizmit dhe e Ndërtimit, në bazë të projektit kryesor dhe zbatues të paraqitur nga investitori.

h) Nëse lartësia e kompensimit është mbi 100.000 € e nën 500.000 €, pagesa nga ana e investitorit mund të bëhet në 3 këste, dhe atë:

- kësti i parë përfshin pagesën prej .................................................... 40 %,
- kësti i dytë përfshin pagesën prej .................................................... 30 %,
- kësti i tretë përfshin pagesën prej ....................................................30 %,

dhe obligimet duhet të përmbushen brenda një (1) viti.

i) Nëse lartësia e kompensimit është mbi 500.000 €, pagesa nga ana e investitorit mund të bëhet në 4 këste, dhe atë:

- kësti i parë përfshin pagesën prej ....................................................30 %,
- kësti i dytë përfshin pagesën prej .................................................... 30 %,
- kësti i tretë përfshin pagesën prej .................................................... 20 %,
- kësti i katërt përfshin pagesën prej .................................................... 20 %,

j) nëse lartësia e kompensimit për rregullimin e tokës ndërtimore arrin mbi 1.000.000,00 €, me kërkesën e investitorit dhe pas pëlqimit të Kryetarit të Komunës, Drejtoria e Urbanizimit, Ndërtimit dhe Mbrojtjes së Mjedisit nxjerr vendim për llogaritjen dhe pagesën e këtij lloji kompensimi, në faza të ndara realizuese të projektit kryesor, për të cilin është dhënë pëlqimi dhe në bazë të të cilit është lejuar ndërtimi dhe obligimet duhet të përmbushen brenda dy (2) vjetëve.

8.2 Pagesa e kompensimit për rregullimin e tokës ndërtimore bëhet para marrjes në dorëzim të lejes së ndërtimit.

8.3. Pagesa e kompensimit të llogaritur me tarifën 8.1, sipas afateve të përcaktuara me Tarifë, lejohet vetëm pas prezantimit të garancisë bankare.

8.4 Lartësia e tarifave për demolimin e objektit është:

- Ngarkesa për demolimin e objektit të ndërtuar pa lejen e organit kompetent për punët e ndërtimit........................................................................13 €/m²,



Adresa: Rr. UÇK- 2-10 000 Prishtinë-Kosovë
Telefon: +381(0)38 230-900
http://www.prishtina-komuna.org

- Ngarkesa për rregullimin e pronës pas demolimit të ndërtimit pa leje nga organi kompetent për punët e ndërtimit........................................................................................8 €/m².

8.5 Shpenzimet e demolimit i bartë investitori, i cili nuk ka poseduar leje për ndërtim nga organi kompetent i Komunës për punët e ndërtimit.

**9. Ngarkesat për shfrytëzimin e burimeve natyrore**

Ngarkesa për shfrytëzimin e burimeve natyrore:
- Materiale të palidhura dhe inerte, rëra dhe zhavorri (aluviane), $m^3$........................................1.25 €,
- Materiale të palidhura dhe inerte, rëra dhe zhavorri (në lum), $m^3$........................................1.25 €.

**10. Bashkëpagesat për Arsim dhe Shëndetësi**

Të gjitha bashkëpagesat, tarifat dhe taksat për shërbime komunale të arsimit dhe shëndetësisë, konsiderohen si të hyra vetanake të institucionit përkatës arsimor dhe shëndetësor dhe të Komunës. Trajtimi, kontabiliteti, raportimi, monitorimi dhe verifikimi i këtyre bashkëpagesave do të bëhet në përputhje me LMFPP-në.

**11. Gjobat**

**11..1 Gjobat nga trafiku**

Gjobat e shqiptuara për shkelje kundërvajtjeje në trafik brenda territorit të komunës, janë të hyra vetanake dhe i takojnë Komunës. Transferet bëhen në përputhje me LMFPP-në dhe do t'i përfshijnë pagesat që bëhen përmes Policisë së Kosovës dhe gjykatave, si rezultat i vendimeve gjyqësore.

**11..2 Gjobat për shkeljen e rregulloreve lokale**

Rregulloret lokale, të miratuara nga Kuvendi i Komunës së Prishtinës, përmbajnë dispozitat ndëshkuese për shkeljen e dispozitave nga bartësit konkretë. Lartësia e gjobës është e bazuar në proporcion me fajësinë e bërë nga shkelësi i dispozitave të rregulloreve komunale.

## III. DISPOZITAT KALIMTARE DHE TË FUNDIT

**Neni 3**

Me hyrjen në fuqi të kësaj rregulloreje, pushon të vlej Rregullorja për tarifa, ngarkesa dhe gjoba komunale, 01 nr. 110 - 493/1 e dt. 12.3.2009, Vendimi për ndryshimet dhe plotësimet e Rregullores për tarifa, ngarkesa dhe gjoba komunale 01. nr. 031 - 2973, të dt 15.12.2010, dhe Vendimi për ndryshimin dhe plotësimin e Rregullores për tarifa, ngarkesa dhe gjoba Komunale 01. nr. 031 – 1663, të dt 19.7.2011.

**Neni 4**

Kjo Rregullore hyn në fuqi ditën e miratimit të saj.

KUVENDI I KOMUNËS SË PRISHTINËS
01. nr.110 - 2782, më 02.12.2011

KRYESUESI I KUVENDIT
Sami Hamiti, ecc. i dipl.



Adresa: Rr. UÇK- 2-10 000 Prishtinë-Kosovë
Telefon: 381(0)38 230-900
http://www.prishtina-komuna.org

## Vjosa Ahmetaj

| | |
|---|---|
| **From:** | Ardian Mehmeti |
| **Sent:** | 09 January 2020 09:29 |
| **To:** | Vjosa Ahmetaj |
| **Cc:** | Ardian Bajraktari; Floriana Rugova |
| **Subject:** | FW: Ftesë për takim - Rregullore për taksa, tarifa dhe gjoba për vitin 2020 KK Prishtinë, Gllogoc dhe Shtime..... |
| **Attachments:** | 43-339-13-2018.pdf; 43-1138-5-2019.pdf; 43-1321-1-2019.pdf |
| **Follow Up Flag:** | Follow up |
| **Flag Status:** | Flagged |

E nderuara znj. Ahmetaj,

Pas shqyrtimit dhe analizimit të Rregulloreve të bashkëngjitura, në cilësinë e anëtarit të Komisionit Ndërministror nga Ministria e Drejtësisë, keni komentet tona, si në vijim:

Sa i përket **Rregullores për taksa, tarifa dhe gjoba komunale për vitin 2020 e miratuar nga Kuvendi Komunal i Prishtinës (plotësim-ndryshim)**, nuk kemi ndonjë koment.

Sa i përket **Rregullores për taksa, tarifa dhe gjoba komunale për vitin 2020 e miratuar nga Kuvendi Komunal i Shtimes (me ndryshimet përkatëse)**, ju njoftoj si në vijim:

**Neni 13** i Rregullores në fjalë është në pajtim me Ligjin nr. 05/L-087 për Kundërvajtje, rrjedhimisht **nenin 7, (paragrafi 1 dhe 2)**, por duhet të jetë në pajtim edhe **me nenin 27, (paragrafi 2)** të Ligjit për Kundërvajtje, pasi që Rregullorja në fjalë në **nenin 1** përcakton **personat fizik dhe juridik** për pagesën e taksave për shërbime të kryera për nevoja të kësaj rregullore si dhe çështje të tjera.

Prandaj, **neni 13** i Rregullores në fjalë, propozoj që të formulohet si në vijim:

*"Mos pagesa për shfrytëzimin e pronës komunale parasheh masën ndëshkuese, marrjen e lejes për shfrytëzim për personat fizik. Ndërsa për personat juridik mund të parashihet vetëm sanksioni kundërvajtës me gjobë".*

Po ashtu, në rrjedhë të kësaj, komuna duhet ta kenë parasysh se shqiptimi i gjobave kundërvajtëse për personat fizik dhe personat juridik (*nëse bëhen nga organi kundërvajtës, nëse ka të tillë*) duhet të jenë në pajtim me **nenin 56, (paragrafi 2, nën-paragrafi 2.2 dhe 2.3)** të Ligjit për Kundërvajtje. Në të kundërtën, nëse procedura kundërvajtëse zhvillohet pranë gjykatës kompetente, atëherë shqiptimi i gjobave kundërvajtëse duhet të jetë brenda limiteve dhe në përputhje me **nenin 29, (paragrafi 4 dhe 5)** të Ligjit për Kundërvajtje.

Sa i përket **Rregullores për taksa, tarifa, ngarkesa dhe gjoba e miratuar nga Kuvendi Komunal i Gllogocit (plotësim-ndryshim)**, komentet tona, janë si në vijim:

Në **nenin 21** të Rregullores në fjalë, **te dispozitat mbi shkeljen e rregulloreve lokale**, ku përcaktohet lartësia e gjobës e cila duhet të jetë në proporcion me fajësinë e bërë nga shkelësi i dispozitave, shqiptimi i gjobave eventuale duhet të jetë në përputhje dhe brenda limitive të **nenit 29 (paragrafi 4 dhe 5)** të Ligjit nr. 05/L-087 për Kundërvajtje.

Ndërsa në **nenin 22 dhe 23** të Rregullores në fjalë ku përcaktohen dispozitat ndëshkimore dhe dënimet mandatore, të njëjtat janë në përputhje dhe brenda limitive me **nenin 29 (paragrafi 4 dhe 5)** i Ligjit për Kundërvajtje.

Konfirmoj pjesëmarrjen time në takimin e së Hënës.

Ju faleminderit!

Me respekt,

**Ardian Mehmeti**
Zyrtar Ligjor
**Ministria e Drejtësisë/Departamenti Ligjor**
Tel: 038 200 18 131
Email: ardian.mehmeti@rks-gov.net
Adresa: Ndërtesa Qeveritare "Rilindja", kati VII/703, Prishtinë

---

**From:** Vjosa Ahmetaj
**Sent:** Wednesday, January 8, 2020 3:02 PM
**To:** Izedin Bytyqi; Burim Rreci; Sabrie Rama; Krenare Sfishta; Ardian Mehmeti; Mirvete Kelmendi; Razije Murtezaj; Avni Rexha; Bislim M. Bislimi
**Cc:** Venera Çerkini; Xhevat Tafa; Gëzim Sahiti
**Subject:** Ftesë për takim - Rregullore për taksa, tarifa dhe gjoba për vitin 2020 KK Prishtinë, Gllogoc dhe Shtime.....

Të nderuar/a,

Si anëtar përgjegjës në komisionin ndërministror për shqyrtimin administrativ të akteve të komunave që prekin fushat e dy a më shumë ministrive, ju ftoj të merrni pjesë në takimin lidhur më shqyrtimin e Rregulloreve për taksa, tarifa dhe gjoba komunale për vitin 2020 të miratuara nga Kuvendi i Komunës së Prishtinës, Gllogocit dhe Shtimes.

Bashkangjitur po ju përcjellë edhe Rregulloret e miratuara nga Kuvendet e Komunave Prishtinë, Gllogoc dhe Shtime. Ju lutem të shqyrtoni secili për pjesën që i përket Ministrisë suaj dhe të përcillni në formë të shkruar komentet tek unë përmes emailit, në mënyrë që gjatë takimit ta nënshkruajmë vlerësimin e rregulloreve komplet si komision përkatës.

***Nga Sekretari i MPMS dhe Sekretari i MTI-së, kërkojmë që të caktojnë zyrtarët të cilët do të marrin pjesë në komisionin për vlerësimin e rregulloreve ashtu siç është caktuar me vendimin e Sekretares së Përgjithshme të MAPL-së.***

Takimi mbahet ditën e **Hënë me datë 13.01.2020**, në **ora 10:30** në zyrat e MAPL-së në Objektin Ish Rilindja Kati 11 Salla e takimeve 11/20.

Ju faleminderit për bashkëpunimin tuaj, njëkohësisht kërkoj nga ju ta konfirmoni pjesëmarrjen në takim.

Me respekt,

Vjosa Ahmetaj
*Zyrtare për Monitorim të Komunave*
*Departamenti Ligjor dhe Monitorim të Komunave – MAPL*
*Tel: +381 (0) 200 35 662*
*E-mail: vjosa.ahmetaj@rks-gov.net*
*Adresa: Pallati i Shtypit Ish-Rilindja*

**Vjosa Ahmetaj**

---

**From:** Razije Murtezaj
**Sent:** 13 January 2020 15:38
**To:** Vjosa Ahmetaj
**Subject:** RE: Ftesë për takim - Rregullore për taksa, tarifa dhe gjoba për vitin 2020 KK Prishtinë, Gllogoc dhe Shtime.....

E nderuar,

Sipas nenit 7 paragrafit 7 të Rregullores (QRK) NR.10/2019 për Shqyrtimin Administrativ te Akteve të Komunave, si përfaqësues nga Ministrie e Financave për shqyrtimin e ligjshmërisë së akteve të komunave që ka të bëjë me fushëveprimin e Ministrisë së Financave, ju rekomandoj si në vijim:

Sipas ***Rregullores për taksa, ngarkesa dhe gjoba komunale për vitin 2020 të Komunës së Gllogoc-it*** neni 13 përcakton taksa për veprimtari të bizneseve në territorin e komunës së Gllogoc-it, taksat duhet të kenë kodet sipas regjistrit të ARBK-se (libri i NACES), po ashtu paragrafët 2 ,3 ,dhe 4 , të nenit 13 të riformulohet p.sh. te fshihet Duke filluar nga viti fiskal 2018 ) , tash jemi në vitin 2020.

Gjithashtu edhe tek neni 24 të fshihet nga komisioni miks i Ministrisë së Financave, të riformulohet si në vijim: Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal.

Po ashtu Rregulloren e komunës së Prishtinës e analizova dhe rekomandoj që të hartohet Rregullorja e re për taksa tarifa dhe gjoba komunale , duke përfshirë te gjitha ndryshimet e jo te vazhdoj plotësim /ndryshime që nga viti 2011.

Për çdo paqartësi jemi në kontakt .

Me të mira!

Razije Murtezaj

---

**From:** Vjosa Ahmetaj
**Sent:** Wednesday, January 8, 2020 3:02 PM
**To:** Izedin Bytyqi; Burim Rreci; Sabrie Rama; Krenare Sfishta; Ardian Mehmeti; Mirvete Kelmendi; Razije Murtezaj; Avni Rexha; Bislim M. Bislimi
**Cc:** Venera Çerkini; Xhevat Tafa; Gëzim Sahiti
**Subject:** Ftesë për takim - Rregullore për taksa, tarifa dhe gjoba për vitin 2020 KK Prishtinë, Gllogoc dhe Shtime.....

Të nderuar/a,

Si anëtar përgjegjës në komisionin ndërministror për shqyrtimin administrativ të akteve të komunave që prekin fushat e dy a më shumë ministrive, ju ftoj të merrni pjesë në takimin lidhur më shqyrtimin e Rregulloreve për taksa, tarifa dhe gjoba komunale për vitin 2020 të miratuara nga Kuvendi i Komunës së Prishtinës, Gllogocit dhe Shtimes.

Bashkangjitur po ju përcjellë edhe Rregulloret e miratuara nga Kuvendet e Komunave Prishtinë, Gllogoc dhe Shtime. Ju lutem të shqyrtoni secili për pjesën që i përket Ministrisë suaj dhe të përcillni në formë të shkruar komentet tek unë përmes emailit, në mënyrë që gjatë takimit ta nënshkruajmë vlerësimin e rregulloreve komplet si komision përkatës.

***Nga Sekretari i MPMS dhe Sekretari i MTI-së, kërkojmë që të caktojnë zyrtarët të cilët do të marrin pjesë në komisionin për vlerësimin e rregulloreve ashtu siç është caktuar me vendimin e Sekretares së Përgjithshme të MAPL-së.***

Takimi mbahet ditën e **Hënë me datë 13.01.2020**, në **ora 10:30** në zyrat e MAPL-së në Objektin Ish Rilindja Kati 11 Salla e takimeve 11/20.

Ju faleminderit për bashkëpunimin tuaj, njëkohësisht kërkoj nga ju ta konfirmoni pjesëmarrjen në takim.

Me respekt,
Vjosa Ahmetaj
*Zyrtare për Monitorim të Komunave*
*Departamenti Ligjor dhe Monitorim të Komunave – MAPL*
*Tel: +381 (0) 200 35 662*
*E-mail: vjosa.ahmetaj@rks-gov.net*
*Adresa: Pallati i Shtypit Ish-Rilindja*

## Vjosa Ahmetaj

**From:** Vjosa Ahmetaj
**Sent:** 14 January 2020 09:57
**To:** Agim Kuleta
**Cc:** Xhevat Tafa; Luljeta.N.Selimi
**Subject:** Njoftim....

I nderuar,

Ju njoftoj se Rregullorja Nr. 01-434/01-315069/19 për ndryshimin dhe plotësimin e Rregullores 01 nr. 110-2782 për tarifa, ngarkesa dhe gjoba komunale e miratuar nga Kuvendi i Komunës së Prishtinës, është ende në vlerësim nga Ministrit e linjës, mirëpo ka vonesa për arsye të pushimeve, andaj kërkojmë që të mos publikohet deri sa të pranoni vlerësimin e ligjshmërisë.

Me respekt,
Vjosa Ahmetaj